



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Lipjanit
Opstina Lipjan
Municipality of Lipjan

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

Bazuar në Ligjin për Zonat Ekonomike Nr. 03/L-129 dhe Udhëzimin Administrativ (MTI) Nr. 03/L-214 për Përcaktimin e Procedurës së kërkesës për marrjen e pëlqimit, procedimit të saj dhe dhënien e pëlqimit, mënyrën dhe procedurat për konsultim publik, si dhe përmbajtjen e regjistrit të Zonave Ekonomike, Komuna e Lipjanit, fton qytetarët në:

KONSULTIM PUBLIK

**Për iniciativën dhe veprimet përgaditore për themelimin e Zonës Ekonomike në Kerqevë
ZK Qylagë - Komuna e Lipjanit.**

Njoftohet publiku, qytetarët e komunës dhe të territorit ku do të themelohet-ndërtohet Zona Ekonomike, se më datën 11.11.2015 në ora 10:00 në sallën e Kuvendit Komunal në Lipjan, do të organizohet konsultim publik nga Komuna e Lipjanit.

Konsultimi publik do të organizohet lidhur me iniciativën për krijimin e Zonës Ekonomike në fshatin Qylagë të komunës së Lipjanit. Përmes këtij konsultimi Komuna duhet të sigurohet që nuk do të ketë pengesa nga ana e qytetarëve për themelimin apo ndërtimin e zonës ekonomike.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

